



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5103/Prot.,  
11

Tiranë më, 15.08.2024

URDHËR

NR. 414, DATË 15.08.2024

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË FEDERATËS SHQIPTARE TË GJIMNASTIKËS

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 16, të ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 564 datë 5.10.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha",

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit të Federatës Shqiptare të Gjimnastikës, propozuar me vendimin nr. 06, datë 16.12.2023, të Asamblesë së Përgjithshme të federatës sportive, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (24 faqe).
2. Federata Shqiptare e Gjimnastikës, të ndjekë procedurat e regjistrimit të statutit pranë gjykatës kompetente, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
3. Statuti ekzistues i Federatës Shqiptare të Gjimnastikës, i miratuar me urdhrin nr. 82, datë 13.02.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e statutit të Federatës Shqiptare të Gjimnastikës" shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin dhe Federata Shqiptare e Gjimnastikës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ENDRIT HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN  
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT  
RREGULLATOR

Nr. 5103 / Prot.

2

Tiranë, më 16.08. 2024

Lënda: Shkresë përcjellëse

**FEDERATËS SHQIPTARE TË GJIMNASTIKËS**

Adresa: Rruga "Liman Kaba", Parku Olimpik Feti Borova, Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 414, datë 15.08.2024, të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për miratimin e statutit të Federatës Shqiptare të Gjimnastikës".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

Erzen Tola

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Zamira Gjini

